
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e çertifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-92882/23 dt.10.05.2023, të pronarëve Jahir Mulolli, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., Mark Gjoni, Skender Bucolli, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Amir Bucolli, Anita Vrajolli Mulolli, Sinan Pllana dhe Nuriye Pllana nga Prishtina, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, për lëshimin e çertifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm “C5/L2” dhe “C5/L3” të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Bashkimi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 21.08.2023, lëshon këtë:

Ç E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LEJOHET pronarëve Jahir Mulolli, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., Mark Gjoni, Skender Bucolli, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Amir Bucolli, Anita Vrajolli Mulolli, Sinan Pllana dhe Nuriye Pllana nga Prishtina dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-92882/23 dt.10.05.2023, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm “C5/L2” me etazhitet 3B+S+P+8 dhe “C5/L3” me etazhitet 2B+S+P+7, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-224855/19 dt 06.07.2020, në emër të Jahir Mulolli, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., Mark Gjoni, Skender Bucolli, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Amir Bucolli, Anita Vrajolli Mulolli, Sinan Pllana dhe Nuriye Pllana nga Prishtina dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., në parcelën kadastrale nr.1654-0 ZK Matičan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Bashkimi”, me numrat 21, 23, 25 & 27 (Ndërtesa “C5/L2) dhe numrat 13, 15 & 17 (Ndërtesa “C5/L3), ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të çertifikatës së përdorimit.

III. Kjo Çertifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e çertifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët: Jahir Mulolli, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., Mark Gjoni, Skender Bucolli, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Amir Bucolli, Anita Vrajolli Mulolli, Sinan Pllana dhe Nuriye Pllana nga Prishtina, me investitor “Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-92882/23 dt.10.05.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e çertifikatës së përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm “C5/L2” me etazhitet 3B+S+P+8 dhe “C5/L3” me etazhitet 2B+S+P+7, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues

Faqe 1 prej 3

“Mati 1”, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.1654-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-224855/19 dt 06.07.2020, në emër të Jahir Mulolli, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., Mark Gjoni, Skender Bucolli, Emri Gashi, Izet Zeqiri, Amir Bucolli, Anita Vrajolli Mulolli, Sinan Pllana dhe Nurije Pllana nga Prishtina dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., në parcelën kadastrale nr.1654-0 ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “C5”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-270755/22 dt. 24.04.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojcës 5 nga Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e çertifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, çertifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Fortesë Ferizi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Zijadin Guri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Muhedin Morina; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agim Binaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Korab Lushta; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Shala; Inçizimin gjeodezik të ndërtesave, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, si dhe Raportin e Inspektimit Final konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e çertifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i çertifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon çertifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë çertifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Çertifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Çertifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Çertifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.



I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-92882/23 DT. 21.08.2023**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazita Kaspiqi



